



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: Zarife Xhoxhaj B.I.
Emri Tregtar: Radio "Dardania"
NUI: 810599136
Pronari: Zarife Xhoxhaj
OSHMA: Radio Dardania
Adresa: Rr/Vetim Shala, p.n. Ortakoll Prizren
Prizren

Emri i Biznesit: Zarife Xhoxhaj B.I.
Emri Tregtar: Radio "Dardania"
NUI: 810599136

Kandidati për pronar: Diar Kabashi

OSHMA: Radio Dardania

Adresa: Rr/Vetim Shala, p.n. Ortakoll Prizren



VENDIM

për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik të Radio Dardania, me seli në Komunën e Prizrenit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Dardania është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin tokësor të programeve të radios, me seli në Prizren. KPM, me vendimin e datës 19 shtator 2016, ka bërë ripërtëritjen e licencës së Radio Dardania edhe për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 2 shtator 2021, Radio Dardania ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e licencës së Radio Dardania nga znj. Zarife Xhoxhaj, tek z. Diar Kabashi në kuadër të biznesit të njëjtë, në të cilin është lëshuar licenca e Radio Dardania, - biznesit me emër tregtar "Radio Dardania" me Numër Unik Identifikues (NUI) 810599136.

Arsyetim


4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".

5. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
7. Përmes kërkesë për ndryshimin e pronësisë, pronarja aktuale e Radio Dardania ka deklaruar se arsyeja për këtë ndryshim është gjendja jo e mirë shëndetësore e saj.
8. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Dardania, përmes një deklarate me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka njoftuar se ka bërë investime në teknologjinë moderne të transmetimit të Radio Dardania dhe ka paraparë që të bëjë edhe në të ardhmen, angazhimin e stafit profesional, rritjen e cilësisë dhe llojeve të programeve, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare kandidati për pronar ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare mbi shkallën dhe burimin e financimit.
10. Komisioni konstaton se, Radio Dardania nuk ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së, pasi që ka obligime në vlerë prej njëmijë (1000.00) eurove në emër të gjobës për mos dorëzimin e ditareve të zgjedhjeve, për të cilën gjobë pronarja aktuale ka parashtruar ankesë në Bordin për Ankesa. Mirëpo, kandidati për pronar të ri të kësaj radioje përmes një marrëveshje me shkrim, në mes tij dhe pronares aktuale të kësaj radio, merr për sipër të gjitha detyrimet e Radio Dardania.
11. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, për investime në teknologjinë e transmetimit, zotimet për angazhimin e stafit profesional, rritjes së cilësisë dhe llojeve të programeve si dhe dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Dardania është në interes të publikut.
12. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

13. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 16 nëntor 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e licencës së Radio Dardania nga znj. Zarife Xhoxhaj, tek z. Diar Kabashi në kuadër të biznesit të njëjtë në të cilin është lëshuar licenca e Radio Dardania, biznesit me emër tregtar “Radio Dardania” me Numër Unik Identifikues 810599136.

14. Komisioni vendos që Radio Dardania të obligohet që brenda 14 ditëve, nga dita e pranimi të vendimit për ndryshim në pronësi, të bëjë ndryshimet e nevojshme në certifikatën e biznesit me emër tregtar Radio "Dardania" dhe me Numër Unik Identifikues 810599136 në Agjencinë për Regjistrimin Bizneseve në Kosovës (ARBK), duke zëvendësuar emrin e pronares së deritanishme znj. Zarife Xhoxhaj me emrin e pronarit të ri të Radio Dardania z. Diar Kabashi, sipas diapozitivit të këtij vendimi.
15. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të Radio Dardania nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.
16. Me anë të këtij vendimi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Radio Dardania barten te pronari i ri.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



22.11.2021

datë